

MESAZHI PASKAL I MITROPOLITIT TE KORÇES- PASHKË 2020



Me Perëndinë edhe në shkretëtirë ne mund të gjejmë Jetën!

Në Dhiatën e vjetër Pashka është historia e çlirimit të popullit të Izraelit të lashtë nga skllavëria dhe e udhëtimit të tyre drejt lirisë dhe tokës së premtuar. Ky rrugëtim i gjatë u bë nëpër shkretëtirë, simbol i mundimeve dhe vuajtjeve. Bibla na tregon se, në përballjen me vështirësitë e shkretëtirës, shumë herë populli e humbi besimin, u tremb nga e panjohura e udhëtimit dhe u dëshpërua. Por, gjatë gjithë këtij udhëtimi të mundimshëm, prej dyzet vjetësh, ishte prania e fuqishme e Zotit, i Cili i ushqeu edhe kur nuk kishin ushqim; i mbrojti edhe kur ata mendonin se ishin të pambrojtur dhe i udhëhoqi dhe i ngushëlloi në çastet e frikës dhe të dëshpërimit. Dhe Zoti shkonte para tyre, ditën në një kolonë reje për t'i udhëhequr në rrugë, dhe natën në një kolonë zjarri për t'u bërë atyre dritë. (Eks. 13:20) Madje, pikërisht në shkretëtirë, një vend ku nuk mund të gjejmë asgjë, Perëndia iu dha atyre Ligjin dhe bëri Bësëlidhjen me ta, duke i bërë popull të Tij.

Në Dhiatën e Re, nëpërmjet Kryqit, Pësimit dhe Ngjalljes, Krishti i dha një dimension të ri dhe më të thellë Pashkës, duke u bërë Vetë Ai, Pashka jonë. Krishti, – shkruan Apostulli – Pashka jonë, u flijua për ne. (1. Kor. 5:7) Ashtu si gjaku i qengjit të Pashkës, i shpëtoi të parëlindurit e hebrenjve nga vdekja; po ashtu, edhe gjaku i Krishtit, i shpëton nga vdekja e përhershme të gjithë ata që besojnë në Atë.

Edhe udhëtimi ynë shpirtëror drejt tokës së premtuar, Mbretërisë së përjetshme, është gjithashtu një udhëtim nëpër shkretëtirë dhe vështirësive që hasen atje. Prandaj Zoti na thotë: Në botë do të keni shtrëngim; po kini guxim, unë e kam mundur botën. (Jn. 16:33) Këto fjalë na japin kurajë dhe shpresë, që edhe kur të jemi në hidhërime, sëmundje dhe vuajtje, qofshin trupore ose shpirtërore, ta ruajmë besimin dhe falenderimin. Sepse, ne e dimë që Kryqi nuk është akti i fundit i jetës tokësore të Krishtit, por Ngjallja. Sado të lodhur të jemi, ne kemi një vend pushimi shpirtëror. Ejani tek unë sa jeni të lodhur e të ngarkuar – na thotë Zoti – edhe unë do t'iu preh ju. (Mt. 11:28)

II

Çdo vit, ne udhëtojmë drej Pashkës, nëpër Kreshmën e Madhe, si një udhëtim në shkretëtirë, me sakrifica dhe duke hequr dorë nga shumë gjëra. Të gjitha sakrificat që bëjmë mund të na lodhin fizikisht, por na forcojnë shpirtërisht. Pashka e sivjetshme, për shkaqe që dihen, është krejtësisht e ndryshme. Nuk na u mundësua festimi masiv dhe në mbarë botën shërbesat fetare po kryhen në kisha pothuaj të zbrazëta. Frika nga infektimi, izolimi i gjatë dhe pasiguria për të ardhmen, krijojnë një atmosferë braktisjeje dhe shkretëtire, e cila në shumë njerëz mund të shkaktojë ankth dhe dëshpërim. Por, “shkretëtira” mund të na ndihmojë për të medituar më thellë dhe për t’i kthyer zemrat tona drejt Perëndisë, për të zbuluar se çfarë është më e rëndësishme në këtë jetë, sepse të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që duan Perëndinë. (Rom.8:28) Me Perëndinë edhe në shkretëtirë mund të gjejmë jetën. Ai mund ta kthejë shkretëtirën në një vend të blertë dhe të freskët, ku nuk ka as dhembje, as lot dhe as hidhërim. Do të bëj – thotë Zoti – që të dalin lumenj mbi kodrat e zhveshura dhe burime në mes të luginave; do ta bëjë shkretëtirën pellgje uji dhe tokën e thatë burim ujërash. (Isaia 41:18)

Ndonëse të ndarë fizikisht, le të qëndrojmë të bashkuar shpirtërisht dhe cilido, që mundet, le të ndihmojë të tjerët që janë në vështirësi, sepse, është dashuria dhe dhembshuria ajo që mund të na japë identitetin si të krishterë të vërtetë. Në këto ditë të vështira, le t’i kujtojmë dhe le të lutemi për të gjithë ata që po përballen me vuajtje të mëdha, madje edhe me vdekjen dhe për të gjithë ata që u shërbejnë atyre me devotshmëri. Le të mos lejojmë që frika të na dobësojë besimin dhe dëshpërimi të na ligësjtojë zemrat. Për të krishterët e hershëm, vuajtjet hapnin një shteg, për të përafruar jetën e tyre me atë të Krishtit, për të marrë pjesë në Kryqin e Tij, me shpresën e pjesëmarrjes në Ngjalljen e Tij. Le të kemi kurajë dhe shpresë, sepse ne kemi një Zot zemërdhembshur dhe mëshirëplotë, i Cili nuk na ka harruar dhe vazhdon të kujdeset për ne. Besimi ynë na mëson se fjala përfundimtare në histori nuk i përket errësirës, por dritës; jo vuajtjes, por shërimit dhe prehjes dhe jo vdekjes, por jetës.

Të dashur vëllezër dhe motra! Le t’i lutemi Krishtit të ngjallur, Mjekut tonë të trupit dhe shpirtit, me fjalët e shën Ambrozit: Kam gjetur një Mjek. Ai banon në qiell dhe e shpërndan shërimin e Tij në tokë. Vetëm ai mund të shërojë dhembjen time, Ai i cili nuk ka asnjë dhembje. Vetëm Ai, i Cili njih gjithçka të fshehur, mund të shërojë dhembjen time, hidhërimin e zemrës sime, frikën e shpirtit tim – Jisu Krishti. Krishti është hir, Krishti është jetë, Krishti është Ngjallje. Amin.

Gëzuar dhe për shumë vjet Pashkët!

Mitropoliti i Korçës,
Pogradecit, Kolonjës, Devollit dhe Voskopojës
+ Joani

— mitropoliaeshenjtekorce.com